Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada – Government*

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 536/13
Datë 24.05.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 24.05.2013 nxjerr këtë:

# VENDIM

1. Për akreditimin e Qendrës për Trajnim dhe Zhvillim "PTK", Prishtinë, për periudhën: 24.05.2013 -24-05.2014 për të ofruar kurse të gjuhës angleze:

   **1.1** Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

   **Kushtet:**

   - Duhet siguruar trajnimi i zyrtarit për sigurimin e cilësisë;
   - Dokumentacioni i plotë lidhur me politikat, procedurat, normat dhe rregullat për sigurimin e cilësisë;
   - Trajnime për atë se çka kërkohet gjatë procesit të akreditimit;
   - Paraqitja e planeve të zhvillimit;
   - Përkufizimi dhe identifikimi i vlerësimit të jashtëm për kurset e gjuhës angleze (siç është CISCO për TI);
   - Trajnime për stafin mësimdhënës bazuar në plan programet e miratuara (duke përfshirë elemente të domosdoshme të anglishtes për qëllime specifike);

- Të ofrojë dëshmi të një politike për zhvillimin e stafit në lidhje me shkathtësitë e mësimdhënies që bazohet në Udhëzimet e AKK-së dhe sistemet efektive për zbatimin e kësaj politike.

**1.1.** Afati i plotësimit i të gjitha kushteve është deri me 30.08.2013.

**2.** Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 24.05.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

**2.1.** Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.
**2.2.** Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

**3.** Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

**4.** Vendimi u dërgohet:

- Qendrës për Trajnim dhe Zhvillim "PTK", Prishtinë;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi